



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 15 maj 2023
Kodi i ZRRE-së: V_1740 _2023

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 25, nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-084),
- Dispozitat e Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë,
- Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2023 për Promovimin e Shfrytëzimit të Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme,
Vendimin V_1160_2019 të datës 05 qershor 2019, dhe
- Vendimin V_1321-2020 të datës 10 dhjetor 2020,

në seancën e mbajtur me datë 15 maj 2023 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **PEZULLOHET** – zbatimi i Rregullës nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë, dhe **NDËRPRITET** pranimi i aplikacioneve për tu trajtuar sipas kësaj Rregulle përfshirë gjeneratorët për vet-konsum të BRE-ve.
- II. Nga data **15.05.2023**, **ZRRE nuk do të pranon** asnjë aplikacion për marrje të autorizimit për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese, për tu trajtuar sipas kornizës së rregulluar dhe skemën mbështetëse për gjeneratorët për vet-konsum.
- III. Përfundimisht dispozitivit nën pikën I. dhe II., të këtij Vendimi, aplikacionet ekzistuese të pranuar para hyrjen në fuqi të këtij vendimi, do të shqyrtohen në përputhje me Rregullën në fuqi në kohën e aplikimit, dhe nuk do të ndikohen nga ky Vendim.
- IV. Ky vendimi nuk do të prodhon efekt prapaveprues për aplikuesit që janë në shqyrtim dhe prodhuesit e energjisë elektrike nga centralët që shfrytëzojnë burimet e ripërtërishme të energjisë.
- V. Fondi për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë do të trajtohet sipas Rregullës Nr. 03/2017 për vendosjen e të Hyrave të Lejuara Maksimale të OST/OT, dhe nuk do të afektohet nga ky Vendim.

A r s y e t i m



- ZRRE, vlerëson se Udhëzimi Administrativ nr. 01/2023 ka përcaktuar obligime të reja për të gjitha institucionet kompetente dhe ndërmarrjet e energjisë si dhe autoritetet tjera kompetente që promovojnë shfrytëzimin e energjisë nga burimet e ripërtëritshme.
- Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2023 përcakton se centralet që shfrytëzojnë burime të ripërtëritshme, mbështeten me Skema Mbështetëse, të përcaktuar sipas këtij Udhëzimi Administrativ.
- Po ashtu Udhëzimi Administrativ ka theksuar se prodhuesit e energjisë elektrike nga centralet që shfrytëzojnë burimet e energjisë së ripërtëritshme mund të përfitojnë nga çmimi i garantuar i blerjes ose premiumet si masa mbështetëse të dhëna në një proces të Ofertimit Konkurrues. Ku procesi i Ofertimit Konkurrues do të zhvillohet nga Ministria e Ekonomisë e cila është përgjegjëse për iniciimin, organizimin dhe zbatimin e procesit të Ofertimit Konkurrues. Prandaj, mbështetja e prodhimit të energjisë nga Burimet e Ripërtëritshme, nga çmimet administrative ndërpritet, për të mundësuar zhvillimin prodhimit të energjisë nga mekanizmat konkurrues.
- ZRRE vlerëson se bazuar në parimin e sigurisë juridike ky Vendim nuk do të prodhojë efekt juridik prapaveprues për aplikimet që kanë parashtruar aplikim zyrtar me shkrim për tu trajtuar sipas rregullës përkatëse, dhe të njëjtit do të shqyrtohen në përputhje me Rregullën në fuqi në kohën e aplikimit, ndërsa për raste tjera nuk aplikohen.
- Fondi i Burimeve të Ripërtëritshme do të vazhdojë të aplikohet si mekanizëm për mbështetjen e gjeneratorëve, i krijuar në bazë të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Legjislacionin sekondar, ashtu që të mundësohet kompensimi i duhur i prodhueseve për prodhimin e energjisë elektrike nga gjeneratorët përkatës.
- Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit dhe analizimit të situatës aktuale dhe kërkesave ligjore si më lartë, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

VI. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

VII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Lutfije Dervishi, anëtar


Gani Buçaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Arkivit të ZRRE-së.